



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE, E VERIFIKIMIT DHE INTEGRIMIT

Nr. 4661/A Prot.

Tiranë, më 21.07. 2021

NJOFTIM

Drejtuar: Autoriteteve Kontraktore

Operatorëve Ekonomikë

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") njofton të gjitha palët e interesuara se, në zbatim të gërmës "b" të nenit 23 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" (në vijim "LPP"), dhe nenit 115 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" është miratuar Udhëzimi nr. 06, datë 16.07.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike".

Udhëzimi dhe manuali teknik shoqërues synojnë të plotësojnë kuadrin rregullator, duke i ardhur në ndihmë autoriteteve/enteve kontraktore në drejtim të mirëzbatimit të legjislacionit të prokurimit publik, sa i takon përdorimit të procedurës së prokurimit "Negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës".

Së pari, APP sjell në vëmendje të autoriteteve/enteve kontraktore që, të jenë të kujdesshëm në për zgjedhjen e kësaj procedure, e cila duhet të përdoret vetëm në rastet që përcakton neni 47 i LPP, kur argumentohen dhe dokumentohen kushtet e parashikuara nga kjo dispozitë.

Së dyti, në çdo rast kur argumentohet dhe provohet se përmbushen kushtet e përcaktuara në dispozitën e mësipërme, autoritetet/entet kontraktore duhet të veprojnë konform parashikimeve të LPP, rregullave të prokurimit publik dhe udhëzimeve të APP.

Duke pasur parasysh ndryshimet e reja ligjore, APP sjell në vëmendjen e autoriteteve/enteve kontraktore dhe të operatorëve ekonomikë parashikimet e reja gjatë përdorimit të kësaj lloji procedure:

- Parashikimi i njoftimit vullnetar për transparencën, si mjet që rrit transparencën dhe i jep mundësi operatorëve ekonomikë të njihen edhe me të dhënat e një objekti konkret prokurimi të planifikuar, për t'u prokuruar nëpërmjet kësaj procedure.

- Parashikimi për herë të parë i së drejtës për ankimim për procedurën e negociimit pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, sipas afateve të mëposhtme:
 - a) 30 ditë nga dita e publikimit të njoftimit të fituesit;
 - b) 10 ditë nga dita e publikimit të njoftimit vullnetar për transparencë, sa i takon plotësimit të kushteve për përdorimin e kësaj procedure prokurimi, si dhe përmbajtjes së dokumenteve të tenderit.

Udhëzimi nr. 06 datë 16.07.2021 dhe Manuali Teknik gjenden të publikuara në faqen zyrtare të APP dhe hyjnë në fuqi menjëherë.

Gjithashtu, APP njofton se, për t'i ardhur në ndihmë autoriteteve/enteve kontraktore, me mbështetjen e Bankës Europiane për Rindërtimin dhe Zhvillimin (BERZH), ka përkthyer në gjuhën angleze dokumentet standarde të tenderit (në vijim "DST") për procedurën e kufizuar për mallra/shërbime/punë. Këto DST gjenden të publikuara në faqen zyrtare të APP.

Duke ju falenderuar,


DREJTORI I PËRGJITHSHËM
Reida Kashta